



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

BORDI DREJTUES

Nr. 149 / Prot. 3

Tiranë, më 02.02.2021

V E N D I M

Nr. 1, datë 02.02.2021

Bazuar në ligjin nr. 17/2018 “Për statistikat zyrtare”, neni 20, Bordi Drejtues i Institutit të Statistikave në mbledhjen e datës 01.02.2021

VENDOSI:

1. Të miratojë planit e rekrutimeve për vitin 2021 sipas aneksit nr.1 bashkëlidhur.
2. Të miratojë planit e trajnimeve për vitin 2021 sipas aneksit nr. 2 bashkëlidhur.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR I BORDIT DREJTUES

ELSA DHULLI



Sekretar i Drejtorit të Përgjithshëm
Gresjana Dervishi

INSTITUTI I STATISTIKAVE

Rr. “Vllazën Huta”, Nd. 35, H. 1, Njesia Administrative N. 2, Tirana, Shqipëri
Tel: +355 (4) 2233356 / 2222411 / 2233358 / 2233357 / Fax: + 355 (4) 2 228300
www.instat.gov.al / info@instat.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
INSTITUTI I STATISTIKAVE

DREJTORIA E FINANCËS DHE PROJEKTEVE
Sektori i Burimeve Njerëzore

Nr. 126 Prot.

Tiranë, më 28.01.2021

Lënda: Propozim për miratimin e Planit Vjetor të Pranimit për vitin 2021 për Institutin e Statistikave, pjesë e Shërbimit Civil.

BORDIT TË DREJTORËVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 18 të Ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil" të ndryshuar, më poshtë gjeni draft-planin vjetor për vitin 2021 për miratim.

1. Numri i vendeve vakantë të planifikuara për rekrutim gjatë vitit 2021 për Institutin e Statistikave, pjesë e shërbimit civil është gjithsej 16, i ndarë sipas kategorive të mëposhtme:
 - 2 (dy) nëpunës civil, të Nivelit të Lartë Drejtues
 - 2 (dy) nëpunës civil, për kategorinë e ulët drejtuese
 - 12 (dymbëdhjetë) nëpunës civil, për kategorinë ekzekutive
2. Grupet e administrimit të përgjithshëm dhe të posaçëm në kategorinë ekzekutive, janë si mëposhtë:
 - Shkenca Juridike
 - Shkenca Kompjuterike
 - Shkenca Inxhinierike
 - Shkenca Ekonomike
 - Shkenca Shoqerore
 - Shkenca Sociale
 - Shkenca Ekzakte
 - Shkenca Bujqësore

NJËSIA PËRGJEGJËSE

DREJTOR I FINANCËS DHE PROJEKTEVE

LILJANA BRAHSA



INSTITUTI I STATISTIKAVE

Rr. Vllazën Huta, Nd. 35, H.1, Njësia Administrative Nr. 2, 1017 Tirana, ALBANIA,
Tel: +355 (4) 2233356 / 2222411 / 2233358 / 2233357 / Fax: + 355 (4) 2 228300

www.instat.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

DREJTORIA E FINANCËS DHE PROJEKTEVE
Sektori i Burimeve Njerëzore

Nr. 127 Prot.

Tiranë, më 28.01, 2021

Lënda: Propozim për miratimin e Planit Vjetor të Trajnimeve, për vitin 2021, për Institutin e Statistikave.

BORDIT TË DREJTORËVE

Zhvillimi dhe menaxhimi eficient i burimeve njerëzore është një ndër faktorët kryesor në efektivitetin e Institutit të Statistikave.

Më qëllim që të përmbushë këtë mision, INSTAT, krahas objektivave strategjik dhe planeve të veprimit në drejtim të prodhimit të statistikave zyrtare, konsideron si të rëndësishëm ngritjen, përmirësimin dhe zhvillimin e vazhdueshëm të njohurive profesionale të përditësuara jo vetëm për personelin e INSTAT, por edhe për përdorues të ndryshëm të statistikave zyrtare.

Në këtë kuptim, duke synuar arritjen e objektivave strategjike të zhvillimit të INSTAT, referuar strategjisë së trajnimeve, është kryer identifikimi i nevojave dhe është hartuar në zbatim plani vjetor i trajnimeve për vitin 2021.

I. Temat e Trajnimeve për punonjësit e INSTAT.

1. Trajnim për stafin e ri pjesë e shërbimit civil.

INSTAT do ti kushtojë një rëndësi të veçantë trajnimit dhe zhvillimit të personelit të ri duke vendosur si prioritet promovimin dhe zhvillimin e tyre të mëtejshëm.

Programi i trajnimit për punonjësit e rinj është pjesë e Programit të Trajnimit dhe Zhvillimit të Institucionit, strategji e cila parashikon instrumentat e duhur, që do të ndihmojnë në rritjen e kapaciteteve të punonjësve.

2. Trajnim për “Cilësinë Statistikore” - niveli baze

Target Grup- do të jenë punonjësit e rinj të Instat. Ky trajnim realizohet duke qënë se cilësia ka qënë gjithmonë një nga rekomandimet e ESS (European Statistical System) për agjencitë statistikore, edhe pse përkufizimi i 'cilësisë' ka ndryshuar ndër vite. INSTAT, në drejtim të angazhimit për përmirësimin e cilësisë, është i përqendruar në çdo aspekt të cilësisë që lidhet me proceset statistikore dhe produktet statistikore, duke mbajtur parasysh zhvillimet e vazhdueshme në këtë fushë.

3. Trajnim “Leadership” për Përgjegjësit e rinj të Sektorëve.

INSTITUTI I STATISTIKAVE

Rr. Vllazën Huta, Nd. 35, H.1, Njësia Administrative Nr. 2, 1017, Tirana, ALBANIA,
Tel: +355 (4) 2233356 / 2222411 / 2233358 / 2233357 / Fax: + 355 (4) 2 228300

www.instat.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

Projekti Sida ka ndihmuar në hartimin e kurrikulës së trajnimit për Leadership për stafin e Instat të cilët do të jenë Trajnerë për Përgjegjësit e rinj të Sektorëve.

Programi trajton komponentet thelbësore të lidershit si aftësitë drejtuese, standardet morale dhe etike, vet-menaxhimi, komunikimi i qartë i pritshmërive, përkushtimi ndaj personelit, udhëheqja kreative, imazhi dhe besueshmëria e liderit dhe institucioneve, fleksibiliteti i ndryshimit të opinioneve, nxënia efiçente, inteligjenca emocionale, bashkëpunimi strategjik, marrëdhëniet me vartësit, komunikimi i vazhdueshëm, tek hapja ndaj ideve dhe trajtimeve të reja, ndjesia e suksesit dhe dështimit në ekip.

4. Trajnim "Data analyses – statistikat ekonomike"

Programi i trajnimit "Macro level analysis of economic statistics" (Analizat në nivel makro të statistikave ekonomike) i cili po ndërtohet në suportin e projektit SIDA, jep një përmbledhje të sistemit të statistikave ekonomike gjithashtu analizohen lidhjet midis statistikave ekonomike me frekuencë të lartë. Analiza e të dhënave shihet në kontekstin e konsistencës midis burimeve të të dhënave të përdorura në përpilimin dhe treguesve të publikuar në fushat e Statistikave afatshkurtra, Statistikave të çmimeve, Statistikave të tregtisë së jashtme dhe PBB tremujore. Moduli i trajnimit paraqet sistemin e statistikave ekonomike në Shqipëri gjithashtu janë analizuar lidhjet midis treguesve për ti bërë më koherente dhe konsistente. Modulet e trajnimit janë: Sistemi i Statistikave Ekonomike; Regjistri Statistikor i Ndërmarrjeve; Llogaritë Kombëtare Tremujore; Statistikat Afatshkurta; Statistikat e Çmimeve; Statistika Tregtisë së Jashtme; Burime të tjera të dhënash.

Trajnimi është planifikuar për punonjësit e rinj të Drejtorisë së Llogarive Kombëtare, Ekonomike dhe të Sektorit Real.

5. Trajnim "Data analyses – statistikat sociale"

Programi i trajnimit i ndërtuar në suportin nga Projekti Sida jep një përmbledhje të: Qëllimit të Anketës, Popullsisë në studim, periodicitetit, modelit dhe kampionimit, fushat kryesore të pyetësorit, procesin e mbledhjes së të dhënave, kohëzgjatjen në terren, Treguesit kryesorë të prodhuar: përkufizimi i treguesve dhe niveli i disagregimit, Konsistenca, Publikimi, Përdoruesit dhe partnerët, Sfidat e së ardhmes, Shembuj dhe linqe me databazën dhe raportet e cilësisë.

Trajnimi është planifikuar për vitin 2021 për punonjësit e rinj të Drejtorisë së Statistikave Sociale.

6. Trajnim në "Statistical Disclosure Control (SDC)"

Ky trajnim ka në fokus punonjësit e Drejtorive Ekonomike dhe të Sektorit Real. Statistical Disclosure Control (SDC) mund të përshkruhet si tërësia e masave që aplikohen për të eliminuar (ose reduktuar) riskun e zbulimit të informacionit individual të

INSTITUTI I STATISTIKAVE

Rr. Vllazën Huta, Nd. 35, H.1, Njësia Administrative Nr. 2, 1017, Tirana, ALBANIA,
Tel: +355 (4) 2233356 / 2222411 / 2233358 / 2233357 / Fax: + 355 (4) 2 228300

www.instat.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

njësive statistikore (të intervistuarit). Këto masa përgjithësisht modifikojnë ose kufizojnë sasinë e të dhënave që publikohen ose aksesohen për qëllime statistike. Në lidhje me SDC do bëhet një përshkrim i përgjithshëm pse është e nevojshme që institucionet të mbrojnë konfidencialitetin dhe metodat që përdoren ndërkombëtarisht për këtë qëllim. Një nga mjetet më të përdorshme për SDC është është Tau-Argus. Në lidhje me këtë aplikacion, do të bëhet shpjegimi i procesit me hapat përkatës për mbrojtjen e tabelave, realizimin e suppression fillestar dhe dytësor me anë të metodave të ndryshme, ruatja e output-it në disa formate dhe krijimi i batch file.

7. Trajnim “Stac Business Course”

Stac Course është një kurs fillestar mbi Metodën e Anketimit të Ndërmarrjeve Ekonomike. Kursi do të mbulojë të gjitha etapat në të cilat kalon një anketë dhe do të përfshijë leksione, shembuj dhe ushtrime konkrete lidhur me Anketat e Ndërmarrjeve. Çështjet kryesore të cilat do të trajtohen në këtë kurs lidhen me: Fazat e një ankete ekonomike; Klasifikimet; Metodën statistikore të mbledhjes së të dhënave; Hartimi i pyetësorit; Plani i tabulimit; Mbulimi; Modelet e zgjedhjes së kampionit; Editimi i të dhënave; Gabime në zgjedhjen e sample-it; Estimimi; Sezonaliteti; Rregullimi i mos përgjigjes (rregullimi i peshës dhe imputimi); Treguesit e cilësisë statistikore; Paraqitja e rezultateve.

Grupi i synuar për këtë trajnim janë punonjësit e rinj të drejtorive prodhuese.

8. Trajnim “Language R”

Kursi për R dhe RStudio ka si fokus fillimisht të shpjegojë instalimin e R, Paketave R dhe përdorimin e GUI që përfshin dhe sintaksën e sriptëve R. Pjesëmarrësit do të mësojnë të përdori RStudio dhe të krijojnë raporte me R-markdown. Gjithashtu do të trajtohet manipulimi dhe vizualizimi i të dhënave. Një komponent i rëndësishëm i kursit do jetë paketa Survey dhe Memisc në R, si dhe validimi i modeleve lineare.

9. Trajnim “Metodat e imputimit dhe editimit”

Për të imputuar vlerat që mungojnë në një grup të dhënash, janë në dispozicion disa metoda. Metoda të mundshme të imputimit përfshijnë: imputimin deduktiv, imputimin bazuar mbi modelet (model-based) (duke përfshirë mesataren, raportin, dhe imputimin e regresionit), dhe imputimi i donatorëve (duke përfshirë ketu imputimin cold deck, imputimin e rastësishëm hot deck dhe imputimin nearest-neighbour si dhe përputhja mesatare parashikuese).

Metoda të ndryshme mund të jenë të dobishme në kontekste të ndryshme. Ky modul përmend disa aspekte të përgjithshme të imputimit që nuk janë të lidhura me një metodë të veçantë, të tilla si përfshirja ose përjashtimi i një termi shqetësues në vlerat e imputuara, përdorimi i imputimit deterministik kundrejt stokastikës dhe përfshirja e

INSTITUTI I STATISTIKAVE

Rr. Vllazën Huta, Nd. 35, H.1, Njësia Administrative Nr. 2, 1017, Tirana, ALBANIA,
Tel: +355 (4) 2233356 / 2222411 / 2233358 / 2233357 / Fax: + 355 (4) 2 228300

www.instat.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

peshave të dizajnit në metodat e imputimit. Ne gjithashtu diskutojmë shkurtime të imputimit të shumëfishtë dhe imputimit masiv.

Trajnimi është planifikuar për punonjësit e statistikave Ekonomike dhe të Sektorit Real.

II. Temat e Trajnimeve në kuadër të Projektit SALSTAT

Në kuadër të projektit “Statistika të Forta Vendore Shqiptare - SALSTAT” - i financuar nga Qeveria Zvicerane që vepron nëpërmjet Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim e përfaqësuar nga Ambasada Zvicerane në Shqipëri, Zyrës Federale e Statistikave Zvicerane dhe Instituti i Statistikave të Shqipërisë (INSTAT) janë planifikuar organizimi i trajnimeve për punonjësit e Bashkive si dhe Zyrave Rajonale.

Trajnimet që parashikohen të realizohen gjatë vitit 2021 në kuadër të këtij projekti janë:

1. Trajnimi “Excel”

Ky kurs trajnimi do të fokusohet në konceptet kryesore të punës me Excel, informacionet teorike se si funksionon në mënyrë të përgjithshme ky program, kush janë funksionet/tablet më të përdorshme të tij si dhe parimet baze të krijimit të grafikëve dhe diagrameve.

Target grupi - punonjësit e Institucioneve/Bashkive

2. Trajnim “Mbetjet e ngurta Urbane”

Ky trajnim realizohet me qëllim që të trajnohen punonjësit që merren me menaxhimin e mbetjeve urbane në Bashki për të mundësuar marrjen prej tyre të të dhënave për mbetje urbane në nivel bashkie nëpërmjet vrojtimit administrativ On-Line në funksion të misionit të INSTAT për prodhimin e statistikave të mbetjeve urbane.

Qëllimi i trajnimit është që punonjësit të fitojnë dije të harmonizuara dhe të unifikuara për veprimtarinë në fushën e mbetjeve përfshirë dhe mbajtjen dhe transmetimin e të dhënave në të gjitha institucionet që i kërkojnë ato sipas një metodologjie dhe modeli unik të përafruar me ato të aplikueshme në vendet e BE-së.

Target grupi - punonjësit e Institucioneve/Bashkive

3. “Njohuri bazë për Statistikat Zyrtare” – pjesa e II-të.

Ky trajnim realizohet me qëllim informimin e ofruesve të burimeve administrative për qëllime statistikore mbi kuadrin ligjor të statistikave zyrtare, organizimin dhe funksionimin e Sistemit Kombëtar Statistikor, rritjen e kapaciteteve profesionale në drejtim të përdorimit të teknikave statistikore për rritjen e cilësisë së burimeve administrative, si dhe të ndihmojë procesin e dokumentimit të të gjithë fazave të punës së grumbullimit të të dhënave administrative deri në transmetimin e tyre në INSTAT.

INSTITUTI I STATISTIKAVE

Rr. Vllazën Huta, Nd. 35, H.1, Njësia Administrative Nr. 2, 1017, Tirana, ALBANIA,
Tel: +355 (4) 2233356 / 2222411 / 2233358 / 2233357 / Fax: + 355 (4) 2 228300

www.instat.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
INSTITUTI I STATISTIKAVE

Gjithashtu, një nga objektivat kryesorë të programit është dhënia e udhëzimeve (guidelines), si dhe e mjeteve (toolkits) për të rritur cilësinë e burimeve administrative me qëllim prodhimin e statistikave zyrtare të besueshme, cilësore dhe me kosto sa më të ulët.

Target grupi - punonjësit e Institucioneve/Bashkive.

4. Trajnim për “Integrimin Evropian”

Prezantim mbi Kapitullin 18 “Statistikat” në kuadër të anëtarësimit në BE dhe përmbushjes së detyrimeve të MSA-së, për përafrimin me Acquis Communautaire. Njohje me detyrimet e Grupit Negociator dhe detyrat e Kryenegociatorit për zhvillimin e negociatave të aderimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian ku INSTAT është anëtar.

Target grupi - punonjësit e INSTAT

Vjollca Lasku

Përgjegjës Sektori Burimeve Njerezore

Miratoi:

DREJTOR I FINANCËS DHE PROJEKTEVE

LILJANA BRAHJA



INSTITUTI I STATISTIKAVE

Rr. Vllazën Huta, Nd. 35, H.1, Njësia Administrative Nr. 2, 1017, Tirana, ALBANIA,
Tel: +355 (4) 2233356 / 2222411 / 2233358 / 2233357 / Fax: + 355 (4) 2 228300

www.instat.gov.al